



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr 5876 Prot

Gjirokastër më 10 : 07 2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 05.07 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 05.07 .2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 05.07 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në auditorin pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:10. Marrin pjesë në mbledhje 16 anëtarë. Mungojnë në mbledhje ,Llogo,Çabeli,Leskaj, Guçe,Peta Feruni, Koçollari, Kristidhi.Shehaj, Aliko, Pandos, Kore, Mahmutaj, Shehaj, Vijnë me vonesë pasi ka filluar mbledhja , Binozi, Çuçani, Qeli Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes. Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

- 1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31. 05.2024.
- 2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.06. 2024”.
- 3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30.06. 2024”.
- 4.P/Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik 2023”.
- 5.P/ Vendim “Për miratimin e dokumentit të parë të PBA-së 2025-2027”.
- 6.P/Vendim “Për miratimin e Planit Vendor të Përshtatjes Klimatike 2024-2040”.
- 7.Raport i monitorimit 4-mujor të buxhetit 2024 në Bashkinë Gjirokastër.
- 8.Të ndryshme.

Miratohet me 16 vota pro rendi I ditës së mbledhjes.


Hidhet në votë dhe miratohet me 16 vota pro procesverbali I mbledhjes së datës 31.05,2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.06. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30.06. 2024”, të cilat miratohen me 16 vota pro.

Kalohet te pika 4 e rendit të ditës:



P/Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik 2023”.

ZNJ. Isaraj: Materiali ka kaluar në Komisionin e Financës.

Nëse ka pyetje rreth materialit:

Z. Brahimi: Doja të pyesja cilat janë arsyt e mosrealizimeve në buxhet?

Z. Golemi: Në pjesën makro buxheti është realizuar në masën 81%, kurse në nivel të ardhurash në masën 105%. Arsyet e çedimit në realizimin e investimeve janë projektet me mbështetjen e donatorëve për shkak të mosrealizimit të afateve, kur aplikojmë dhe marrim informacion nga hipoteka na del tokë shtet, kur fillojmë me zbatimin dalin probleme pronësie, dikush ka një ndërtesë në process legalizimi, dikush një pronë dhe kjo shtyn më tej të gjitha procedurat dhe afatet ligjore të prokurimeve.

Gjithashtu edhe te Loti I dytë në rrugën e Zhulatit ka patur një problem me oponencën dhe me procedurat e prokurimeve.

Ndriçimi public ka filluar në lagjet e qytetit dhe ka vazhduar në zonat e mbrojtura.

Në lagjen “Dunavat 1” ka filluar investimi dhe patëm një ndërprerje sepse banorët e donin me beton, për këtë sjellin vonesa, sepse nuk mund të punohet me beton ndërkohë që kalldrëmi është vlerë e shtuar dhe nuk mund të punohet me beton në zonat e mbrojtura.

Z. Brahimi: Me rrugën e Zhulatit çfarë do bëhet? Në Kordhocë mungon ndriçimi.

Z. Golemi: Lazarati është I përfshirë te lagjet e qytetit, ndërkohë ndërhyrje emergjente patjetër që do të ketë.

Edhe me rrugën e Zhulatit do të vazhdohet me lotin e dytë për lidhjen Taroninë -Zhulat.gjithashtu më problem kemi rrugën e Golemit dhe jemi duke kërkuar nga FSHZH për mundësinë e lidhjes së Golemit me zonën e Kurveleshit.

Z.Brahimi: Po për rrugën e fshatit Kardhiq, a keni ndonjë project, sepse ky fshat ka kalanë dhe resurse kulturore dhe historike

Z. Golemi;Deri tani edhe në nivelin e investimeve jemi nisur nga nr I banorëve, në Zhulat banojnë 100 familje dhe shumicën e të ardhurave ne I marrim nga qyteti dhe investojmë në fshatra.

Po investohet te rruga te shkolla Pedagogjike për të eliminuar përmbytjet që na shkaktoheshin në dimër.

Përsa I përket rrugës së fshatit Kardhiq ke të drejtë, është asrt dhe nëse do kemi mbështetje mund ta parashikojmë në buxhetin e ardhshëm dhe ta fillojmë për promocion, por këtë vit kemi investimin në rrugën e Plesatit.

Z. Drasa. Për ndërhyrjen në Dunavat duhet përdorur vetëm guri I zi, sepse pjerrësia është e madhe, nuk duhet përdorur beton dhe nuk mund të pengohet një investim, port ë përshtatet me terrenin me gur të zi.

Qyteti ynë ka dhe privilegje por edhe detyrime si pasuri e UNESCO për të ruajtur rregullat dhe standardet e një qyteti të mbrojtur.Jemi në prag të fillimit të punimeve në rrugën nga Këshilli I Qarkut në lagjen “ Granicë”, të cilën e shtymë për shkak të sezonit turistik.

Përsa I përket nga 10 shkolla kemi zgjedhur 2 shkolla “A.Z. Çajupi” dhe shkollën “Urani Rumbo”

Për punimet që janë kryer ka patur edhe ankesa të cilat janë shqyrtuar dhe janë zgjidhur Brenda projekteve, por edhe duke ndryshuar. Është aprovuar dhe do të vazhdojë ndërhyrja, e cila është ndërprerë për momentin nga “ Shtatë Krojet” te QKF-ja.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro dhe një abstenim, znj Cacaj

P/Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik 2023”.

Kalohet të pika 5. P/ Vendim “Për miratimin e dokumentit të parë të PBA-së 2025-2027”.

Matëriali ka kaluar në Komisionin e Financës.

Z. Golemi: Ky është dokumenti I parë I PBA-së, I cili ka amicjet e veta të cilat bazohen në të ardhurat afatmesme.

Miratohet me 18 vota pro.

Prezantohet nga znj Alesja Llapaj “Plani Vendor i Përshtatjes Klimatike 2024-2040 për Bashkinë Gjirokastër”.

Hidhet në votë dhe miratohet me 18 vota pro P/V “Për miratimin e Planit Vendor të Përshtatjes Klimatike 2024-2040”.

Kalohet te pika 7. Raport i monitorimit 4-mujor të buxhetit 2024 në Bashkinë Gjirokastër.

Z. Brahim: Të ardhurat për 4 mujorin e parë janë mledhur 76% dhe shpenzimet në masën 37 %. Si e ka menduar ekzekutivi ta zgjidhë këtë situatë?

Gjithashtu në lagjen “18 Shtatori” për parkimin e makinave mendoj se duhet të jepen me orar dhe tabelat të tregojnë për sa orë është i rezervuar parkimi, sepse ka edhe shkelje dhe tabela fictive.

Z. Golemi: Përsa I përket realizimit të të ardhurave, aty janë dhe bizneset fillojnë me pagesat pas 6-mujorit të parë, meqë dhe detyrimet janë vjetore I lëmë kohë biznesit për pagesat dhe më pas fillojnë në zbatim edhe të procedurave ligjore.

Të ardhurat nga parkimet zënë një pjesë të mirë të të ardhurave dhe janë rritur kërkesat edhe nga rezidentët edhe nga bizneset dhe nuk kam informacion për dhënie parkimi pa pagesë.

Nëse keni informacion depozitoheni pranë policisë bashkiake.

ZNJ. Cacak: Kan ngritur disa herë shqetësimin për problemin te shkolla “Naim Frashëri” për një tabelë për kufizim shpejtësie. të paktën të jetë gati për muajin shtator.

Gjithashtu edhe problem që kemi ngritur në mbledhjet e kaluara për shqetësimin e disa familjeve në lagjen “18 Shtatori” dhe “Kodra e Shtufit” ku investimi është I FSHZH, por edhe ata mund të gabojnë dhe pse më parë nuk ju duhej të shkonin te “Ura e Lumit” për të shkuar më pas në shtëpitë tyre, ju është vështirësuar lëvizja.. Ishim në rastin e dokt. Vjollcës ku pas ankesës u krye ndërhyrja dhe u rregullua, nuk mund të pengohet një lagje e tërë.

Z. Golemi: Planin e Mobilitetit për lëvizshmërinë në Bashkinë Gjirokastër nuk e ka bërë as FSHZH, as Bashkia Gjirokastër, por nga specialistë të cilët e gjykojnë më gjerë problemin, nuk flas dot para specialistëve të fushës.

Z. Drasa: Ka kaos në lëvizje, ka nevojë për tabela në rrugën Manalat -Cfakë, linja e Palorto- së me probleme. Duhet të ketë një grafik dhe informacion për qytetarët.

Z. Golemi: Jam I informuar dhe ju e dini sa probleme na hapi linja e lagjes “Cfakë”, sepse kontrata është dhënë si shoqëri dhe ata funksionojnë si individ. E di që ky shërbim çalon dhe me ndihmën tuaj mund ta rregullojmë, sepse ajo si kontratë ka rënë në momentin që nuk zbatohen detyrat e caktuara në kontratë.

Kalohet te materiali në ndihmë të sportistes Orila Trako I cili është propozuar dhe miratuar në mbledhjen e kaluar P/Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “ Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” me 17 vota pro.

Mbyllet mbledhja në orën 13: 15 nga znj Isaraj.

Sekretar
Etleva YZO



KRYETAR I KËSHILLIT

